
ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Nr. 19-BD/2026
Prishtinë: 03.11.2026

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.14, si dhe neneve 41 dhe 42 të LIGJIT NR. 08/L–012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 23, paragrafi 5, nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafët 1.20 dhe 1.21, si dhe nenit 21, paragrafi 2 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokolli 8648/24; duke u bazuar në procesverbalin Nr. 41/2026 të mbledhjes së Bordit Drejtues, të mbajtur më 03.11.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Për pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve dhe shërbimeve administrative të OIRK-së

1. Pezullohen përkohësisht aktivitetet dhe shërbimet administrative të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, duke filluar nga data 05.11.2026, deri në sigurimin e financimit të nevojshëm nga Ministria përgjegjëse për planifikim hapësinor dhe ndërtim dhe krijimin e kushteve për rifillimin e funksionimit të rregullt të Odës.
2. Gjatë periudhës së pezullimit, administrata e Odës ndërpret përkohësisht ofrimin e shërbimeve për anëtarët dhe zyrat e OIRK-së mbeten të mbyllura. Ky vendim nuk nënkupton pezullimin e licencave profesionale të anëtarëve të Odës.
3. Anulohet pjesëmarrja e delegacionit të OIRK-së në Asamblenë e Përgjithshme të ECEC-së në Dubrovnik, të planifikuar për datat 6–7 nëntor 2026, për shkak të pamundësisë së mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe pjesëmarrjes.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komisionit Ministror për Themelimin e Odave (KMTHO), së bashku me shkresën përkatëse njoftuese.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 05.11.2026.

ARSYETIM

Në mbledhjen e datës 03.11.2026, Bordi Drejtues shqyrtoi gjendjen e rënduar financiare të OIRK-së dhe ecurinë e procedurës së finalizimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë për realizimin e grantit për vitin 2026. Pavarësisht dokumentacionit dhe sqarimeve të dorëzuara, financimi ende nuk ishte siguruar.

Mungesa e mjeteve financiare ka pamundësuar pagesën e pagave të administratës dhe të kompensimeve për organet e grupet punuese, si dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj ofruesve të shërbimeve dhe furnizimeve të domosdoshme. Bordi vlerësoi se këto rrethana e bëjnë objektivisht të pamundur vazhdimin e rregullt të shërbimeve administrative dhe se pezullimi i përkohshëm është masë e domosdoshme për të shmangur krijimin e detyrimeve të mëtejshme financiare, deri në sigurimin e kushteve për rifillimin e funksionimit.

Vendimi i dërgohet:

- *Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / KMTHO-së;*
- *Anëtarëve Themelues të Odës.*
- *Arkivit të OIRK-së.*

Bashkëngjitur: *Shkresa njoftuese drejtuar Ministrisë për këtë vendim.*

Për Bordin Drejtues të OIRK-së

Arsim Rapuca

Kryetar i OIRK-së